



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



---

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**Komiteti për Komunitete**

**Data: 17.04.2026**

**Për: Anëtarët e Komitetit për Komunitete – KpK**

**FTESË**

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojmë që të merrni pjesë në mbledhjen e II-te të Komitetit për Komunitete për vitin 2026. Mbledhja do të mbahet me dt. 23.04.2026 (e enjte), ora: 10:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

*Vërejtje: Komiteti për Komunitete mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.*

**RENDI I DITËS**

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Aprovimi i procesverbalit.
3. Raporti i Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



---

**SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ**

**Komitet za Zajednice**

**Datum: 17.04.2026**

**Za: Članove Komiteta za Zajednice- KZ**

**POZIV**

Poštovani članovi/članice,  
pozivamo vas da učestvujete na II sednici Komiteta za Zajednice za 2026. Godinu, koja će biti održana 23.04.2026 (u četvrtak) u 10:00 časova u Sali Komiteta za Politiku i Finansije.

Napomena: Komitet za Zajednice zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

**DNEVNI RED**

1. Usvajanje dnevnog reda.
2. Usvajanje zapisnika.
3. Izveštaj šefa kancelarije za povratak i zajednice.
4. Razno.

Prdesedavajući Komiteta za Zajednice



## KOMITETI PËR KOMUNITETE

### PROCESVERBAL

Procesverbal i takimit të I-rë të Komitetit për Komunitete e datës 27.03.2026 (e premte) me fillim në ora 10:00.

Takimi është mbajtur në sallën e Komitetit për Politike dhe Financa.

Në takim kanë marrë pjesë anëtarët të komitetit:

1. Dafina Dragaj ----- Anëtare e Kuvendit - LDK
2. Vjendita Kelmendi Gërgoci ----- Anëtare e Kuvendit - (AAK)
3. Mubera Belegu ----- Anëtare e Kuvendit - (LVV)
4. Muamel Dubljak ----- Anëtare e Kuvendit - (BSK)
5. Mirsad Berisha ----- Anëtare e Kuvendit - (PLE)
6. Milos Dimitrijevic ----- Përfaqësuesi i komunitetit Serb
7. Omer Dacic ----- Përfaqësuesi i komunitetit Boshnjak
8. Edmir Delija ----- Përfaqësuesi i komunitetit Egjiptjan
9. Sofije Toska ----- Përfaqësuese e komunitetit Rom

- Në mungesë të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës, z. Regjep Kurtbogaj, mbledhjen e hapi sekretari i Kuvendit, z. Avni Gashi.

#### **Përveç anëtarëve të Komisionit për Komunitete, morën pjesë edhe:**

z. Mirzet Dzogovic – Nënkryetar për Komunitete , z-nja Valbone Belegu OSCE,z-nja Ajshe Qelaj UMNİK .

#### **RENDI I DITËS**

1. Aprovimi i rendit të ditës
2. Zgjedhje e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete
3. Të ndryshme

## **1.-2- Miratimi i Rendit të Ditës**

Z. Avni Gashi i cili e udhëhoqi takimin, përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes së KZ-së.

Rendi i ditës është propozuar dhe miratuar njëzëri.

Pas prezantimit të anëtarëve të Komitetit për Komunitete, u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës: Zgjedhja e kryesuesit për mandat katërvjeçar të KpK-së.

### **2.1 - Zgjedhje e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete**

Kjo pikë u aprovua unanimisht.

Fjalën e mori z. Omer Dacic, i cili, duke shprehur konsideratë dhe respekt, propozoi që kryesues i KpK-së për këtë mandat të jetë z. Muamel Dubljak (BSK), duke e vlerësuar si profesionist dhe të denjë për këtë përgjegjësi. Z. Omer Dacic tha që posedon aftësi të përgjithshme dhe menaxheriale, si dhe zotëron dygjuhësinë në gjuhën Boshnjake dhe Shqipe.

Z. Omer Dacic gjithashtu deklaroi se edhe Më herët, këtë funksion për tri mandate e kanë ushtruar përfaqësuesit e komunitetit Egjiptian, të cilët i kemi mbështetur pa rezervë, pasi nuk kishin mjaftueshëm vota për të marrë pjesë në pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Pejës. Këtë herë ata kanë fituar një numër më të madh votash dhe janë të pranishëm në pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Pejës, gjë që na sjell kënaqësi të veçantë.

Propozimi u hodh në votim me ngritje dore dhe u miratua unanimisht nga të gjithë anëtarët.

Pas zgjedhjes, kryesuesi i ri, z. Muamel Dubljak, falënderoi për besimin e dhënë dhe u zotua se gjatë mandatit të tij do të punojë me përkushtim në shërbim të të gjitha komuniteteve dhe qytetarëve pa dallim.

Më pas, z. Avni Gashi vazhdoi me pikën e radhës: zgjedhja e zëvendëskryesuesit. Me propozimin e anëtarëve, u votua znj. Dafina Dragaj (LDK), e cila u zgjodh unanimisht.

Në fjalën e saj, znj. Dragaj theksoi se do të punojë me përkushtim dhe ndjeshmëri, duke qenë e barabartë dhe përgjegjëse ndaj të gjithë qytetarëve, ashtu si në mandatin e parë, ashtu edhe në vazhdim.

Në vazhdim u diskutuan edhe

- Plani i punës për vitin 2026
- Menaxhimi dhe bashkëpunimi për takimet e ardhshme

Në fund, duke falënderuar për bashkëpunimin z. Mirzet Dzogovic, si dhe përfaqësueset e organizatave OSBE dhe UNHCR për mbështetjen e vazhdueshme, mbledhja e KpK-së për muajin mars u mbyll.

Në Pejë,  
Me datë  
27.03.2026god.

Procesmbajtëse  
z-nja Dafina Draga

